



Npi – 01/167 datë: 02.05.2025

Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenin 58.3 të Ligjit, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Neni 27 i Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024; Nenin 2.3, dhe nenin 7.1 shkronja (i), dhe nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Si dhe mbi bazën e prezantimit të Propozim-Vendimit Nr.11/44 dt.28.03.2025 për bartjen e të hyrave nga viti 2024 në vitin 2025 nga Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 02.05.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E BARTJES SË TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në Seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më: 02.05.2025, me shumicën e votave miratoi Vendimin për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025, sipas tabelës në vijim:

Nr.	Ko di i OB	Kodi Ekono mik	Kodi i proponuar i programit për vitin 2024	Kodi i projektit në vitin 2025	Programi Buxhetor	Emërtimi i projektit	Ndryshimi i proponuar për vitin 2025 në €
1	617	20	160(16007)		Zyra e Kryetarit	Subvencione dhe Transfere	2,000.00
2		30	660(66340)	55132	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve: Rr.Ulqini seg.-I- Rr.Jashari. Vazhdim i trotuarit në Muzeqinë	7,988.13
3		30	660(66340)	55149	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Rregullimi i rrugëve dhe ndriçimit në Shtime: Rr.Sefë Kosharja, Sami Frashëri, Enver Gashi, Sahide Metushi dhe Rivitalizimi i Rr.2 Korriku	9,271.45
4		20	480(48007)		Zhvillim Ekonomik	Subvencione dhe Transfere	12,600.00
5		20	755(75531)		Sherbimet Sociale	Subvencione dhe Transfere	10,000.00
6		20	850(85007)		Shërbimet kulturore	Subvencione dhe Transfere	42,800.00

7		20	470(47047)		Zhvillimi dhe Inspektimi Bujqësor	Subvencione dhe Transfere	40,000.00
8		13	920(94380)		Arsimi i Mesëm	Mallra dhe Shërbime	16,906.21
9		13	180(18451)		Menaxhimi i katastrofave natyrore	Mallra dhe Shërbime	50,000.00
10		13	920(93180)		Arsimi Fillor	Mallra dhe Shërbime	19,664.49
11		30	850(85007)		Shërbimet kulturore	Rregullimi i Stadionit në Lagjen e Pajtimit	25,000.00
12		30	920(93180)	56114	Arsimi Fillor	Rregullimi i sallave sportive të shkollave në Muzeqinë e Carralevë	18,254.77
13		13	730(73450)		Shëndetësia Primare	Mallra dhe Shërbime	11,963.01
						TOTAL:	266,448.06

II

A r s y e t i m: Në bazë të Propozimit për ndarjen e të Hyrave të Bartura nga viti 2024 në vitin 2025 janë bërë ndryshime (rritje) në strukturën e kategorive ekonomike.

- Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve kemi rritje prej 98,533.71 €
- Në kategorinë e Investimve Kapitale kemi rritje prej 60,514.35 €
- Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve kemi rritje prej 107,400.00 €

E gjithë kjo rritje vjen si rezultat i tejkalimit të projekcionit të Hyrave Vetanake në shumën prej 194,636.27 €. Shuma tjetër prej 26,560.77 € janë mjete të pashpenzuara nga fondi 21, ndërsa shuma prej 45,251.02 € janë mjete të pashpenzuara nga fondi 22. Në total vlera e mjeteve për bartje e THV nga viti 2024 në vitin 2025 është 266,448.06 €.

- Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve janë planifikuar për mbulimin shpenzimeve të nevojave për DSHP, marëveshjet për Fondin e Eficientë të Energjis, dhe një pjesë janë mjete të QKMF-së të cilat i kanë arkëtuar më shumë se sa planifikimi i tyre që kanë pas.
- Në kategorinë e Investimve Kapitale janë planifikuar për përfundimin e dy projekteve të Drejtorisë e Urbanizmit, një pjesë është për Stadiumin e Futbollit në Laxhe të Pajtimit - Faza e parë, dhe pjesa e tjetër është për Rregullimin e sallave sportive të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë.
- Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve janë të planifikuara për përfundimin e katër marrëveshjeve, dy të Drejtorisë e Bujqësisë, një të Drejtorisë e Shëndetësisë dhe një të Drejtorisë e Inovacionit. Shuma prej 42,800.00 € është të Kultura për shkak se mjetet që i kanë pasur në buxhet nga Granti Qeveritar ja ka marrë Thesari për mbulimin e vendimeve Gjyqësore.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë të Financave dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi